



Raport mbi procesin KOMRA

Janar – qershor 2014

Nga muaji korrik i vitit 2013, kur formalisht ka filluar me punën Ekipi i Ekspertëve Rajonal, të cilin e përbëjnë të dërguarit personal të kryetarëve/anëtarëve të Presidencës së B dhe H për KOMRA, „KOMRA ia ka dalë të bëjë vetëm edhe një hap deri sa të bëhet organ ndërshtetëror, i cili merret me çështjet e së kaluarës“.¹ Në këtë fazë të re, të dërguarit për KOMRA e kanë për detyrë të përgatisin dokumentin mbi kushtet kushtetuese, juridike dhe politike për themelimin e KOMRA-s. Në kryerjen e kësaj detyre, avokuesit publik dhe Këshilli Rajonal për KOMRA iu ofron ndihmë profesionale dhe operative, kurse Kuvendi i Koalicionit, më së voni deri në muajin tetor të vitit 2014, do të jap vlerësimin lidhur me atë nëse propozimi ndërshtetëror i përgjigjet intencave të Statutit të KOMRA-s, të cilin e propozon Koalicioni.

Ikja e Aca Todoroviqit

Aca ka qenë një nga 25.671 banorët e fshirë të Sllovenisë, njerëz të cilët në mënyrë arbitrare janë fshirë nga regjistri i banorëve me qëndrim të përhershëm. Është gjetur i vdekur në Ptuj në datën 15 shkurt të vitit 2014. Aca ka qenë një nga ata të guximshmit dhe, në të njëjtën kohë, një nga më të mirët. Ka dalë nga anonimiteti dhe, megjithëse ka qenë pa dokumente, është dalluar në publik, ka filluar të flasë mbi personat e fshirë, të organizojë personat e tjerë të fshirë, të luftojë. Në fillim ka qenë i pasigurt, por kokëfortë, i vendosur dhe i papërkulur. Rreth vetes kishte mbledhur një grusht njerëzish, të cilët kanë qenë të gatshëm që të shfaqen publikisht dhe, kështu, atë që në mënyrë iluzore ka qenë inekzistente, e ka futur drejtpërdrejt në realitet. Njeriu, i cili me forcat e tij vetjake ka dalë nga humnera e mosekzistimit, ia ka kthyer dinjitetin vetvetes dhe të tjerëve, është bërë personalitet dhe qenie e përgjegjshme politike. Ka qenë një avokues i madh i themelimit të KOMRA-s.

I falemi guximit, të cilin e ka treguar Aca Todoroviqi.

Aktivitetet e Koalicionit për KOMRA

Me rastin e njëzet e dyvjetorit të rrëmbimit dhe të vrasjes së 19 udhëtarëve myslimanë, shtetas të Malit të Zi dhe të Serbisë, nga treni në stacionin Shtërpce, Qendra për Arsimimin Qytetar (QAQ), në datën **27.02.2014**, ka mbajtur konferencën për shtyp, në të cilën ka vlerësuar se fushat e drejtësisë penale në rastin e viktimave të trenit janë të vogla dhe se është i vërejtshëm mosprocesimi i kryerësve me shtetësi malaziase. QAQ ka vënë në spikamë edhe nevojën e zbatimit të instrumenteve të tjera për vërtetimin e fakteve, siç është KOMRA, që ka potencial për të parandaluar harrimin kolektiv të krimeve.

Koalicioni për KOMRA, të cilin e kanë përbërë Nikolla Knezheviqi, koordinator i Koalicionit për KOMRA për marrëdhëniet me bashkësitë fetare, Dragan Pjevaç, anëtar i Koalicionit për KOMRA, Xhenana Karup-Drushko, avokuese publike e Nismës për KOMRA, dhe Natasha

¹ Fjalët e profesorit Zharko Puhovski në konferencën për shtyp të avokuesve publik, të datës 24.01.2014 në Beograd.

Kandiçi, koordinator e procesit KOMRA, në datën **6.04.2014** kanë biseduar në Mostar me peshkopin hercegovas-zahumas Grigorijen. "Qasja selektive ndaj viktimave është problem i madh dhe është jashtëzakonisht e rëndësishme që secila viktimë ta ketë emrin e vet", ka thënë peshkopi Grigorie dhe ka theksuar „se të gjitha paragjykimet duhet të lihen mënjanë në mënyrë që të arrihet deri te numri i saktë i viktimave dhe emri i tyre“. Ai ka thënë se do të angazhohet që Republika Srpska t'i bashkohet themelimit të KOMRA-s, sepse „emërtimi i viktimave është në interes të të gjitha viktimave, pa marrë parasysh besimin ose kombësinë“.

Qendra për Hulimtimin dhe Krijimin e Politikave, gjatë muajit prill dhe maj (QHKP) e ka prezantuar procesin KOMRA në datën **13.04.2014** në Mavrovë [Maqedoni] në seminarin kushtuar rolit të të rinjve në ballafaqimin me të kaluarën.

Gjatë muajit prill dhe maj të vitit 2014, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi (YIHR), Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH), Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe QHKP i kanë organizuar **pesë aksione rrugore** me sloganin *E përkrah KOMRA-n*, gjatë të cilave aktivistët e Koalicionit për KOMRA i kanë mbledhur nënshkrimet për themelimin e Komisionit, e kanë shpërndarë fletushkën *E përkrah KOMRA-n*, dhe i kanë paralajmëruar aksionet *Vrapoj për KOMRA-n* në kuadër të maratonës në Beograd, në Prishtinë dhe në Shkup. Në aksionet e përmendura, në Beograd e kanë nënshkruar peticionin për themelimin e KOMRA-s 284 qytetarë, në Shkup **188**, dhe në Prishtinë 161 qytetarë.

QHKP, në datën **10.05.2014**, në Shkup ka organizuar **konferencën për shtyp**, në të cilën për procesin KOMRA kanë folur avokuesi publik dr. Zidas Daskalovski, koordinatorja kombëtare Petranka Kostadinova Miladinova, Ilija Nikolovski nga Shoqata e Veteranëve të Luftës dhe të Policisë dhe Abedyn Zymberi nga Shoqata e Veteranëve të Armatës Kombëtare Çlirimtare iu kanë bërë thirrje, posaçërisht të rinjve, që me pjesëmarrjen e tyre në aksionin *Vrapoj për KOMRA-n*, nën përkujdesjen e maratonës në Shkup, të tregojnë përkrahjen e tyre për themelimin e KOMRA-s.

Në aksionin *Vrapoj për KOMRA-n* [5km] në kuadër të maratonës beogradase², në datën **27.04.2014**, krahas aktivistëve të rinj të Koalicionit për KOMRA, kanë marrë pjesë edhe qytetarët, të cilët në mënyrë aktive e përkrahin Nismën për themelimin e KOMRA-s, si dhe individ, të cilët me vite merren me sportin në mënyrë rekreative. Ata kanë arritur të parët në cak. Aksioni *Vrapoj për KOMRA-n* posaçërisht ka qenë i pranuar në mesin e të rinjve në Prishtinë³. Më shumë se 100 të rinj, në datën **11.05.2014**, kanë marrë pjesë në maratonën e parë në Kosovë, në bluza me shenjën KOMRA. Pothuajse të gjithë kanë arritur në cak. Figura e aktivistëve të Koalicionit KOMRA, pjesëmarrësve të maratonës, është gjetur në faqen e parë online të RTK-së. Po ashtu ka qenë e dallueshme pjesëmarrja e aktivistëve të Koalicionit KOMRA, në të njëjtën ditë, në Shkup⁴. Së paku 60 të rinj kanë startuar në bluzat me shenjën e KOMRA-s, kurse cakun [5km] e kanë kaluar më shumë se gjysma e tyre.

Përkrahja e KOMRA-s në dokumentimin e kampeve të përqendrimit dhe të vendeve të tjera të ngujimit⁵

² Organizator i aksionit të pjesëmarrjes në maratonë ka qenë YIHR.

³ Organizator ka qenë FDHK.

⁴ Organizator ka qenë QHKP.

⁵ Në fillim të vitit 2012, Koalicioni për KOMRA-n e ka përkrahur propozimin e avokuesve publik, të profesorit Zdravko Grebo, Xhenana Karup Drushkos dhe Dino Mustafiqit, mbi themelimin e dy organizatave joqeveritare, njëra me seli në Banja Llukë, tjetra me seli në Sarajevë, të cilat do të ofronin përkrahjen teknike për procesin KOMRA, kurse me kohë, me sigurimin e pavarur të mjeteve, që të ngrisin projekte, të cilat i kontribuojnë

Shoqata „Drejtësia tranzicionale, përgjegjësia dhe kujtimi në B dhe H” (DTPK), me seli në Sarajevë, dhe Qendra për Demokracinë dhe Drejtësinë Tranzicionale (QDDT), me seli në Banja Llukë, nga muaji korrik i vitit 2013, në mënyrë të përbashkët e zhvillojnë projektin „Krijimi i hartave të kampeve të përqendrimit dhe i vendeve të tjera të ngujimit në B dhe H“, i cili e ka për qëllim që t’i ndihmojë KOMRA-s në realizimin e detyrës për „mbledhjen e të dhënave mbi vendet e ngujimit në lidhje me luftën, mbi personat të cilët në mënyrë të kundërligjshme janë mbyllur, i janë shtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor, si dhe që të përpilojë një regjistër gjithëpërfshirës“, i cili është i paraparë me Propozim Statutin e KOMRA-s. Në muajin shkurt të vitit 2014, DTPK dhe QDDT e kanë mbajtur konferencën e parë për shtyp, në të cilën i kanë prezantuar profilet e 15 kampeve të përqendrimit si rezultat i analizës së dokumentacionit gjyqësor dhe i intervistave, të cilat hulumtuesit i kanë zhvilluar me ish të burgosurit në kampet e përqendrimit. Mediat, me një përkrahje dhe me vëmendje të madhe kanë raportuar mbi fillimin dhe rezultatet e para të projektit, kurse shoqatat e të burgosurve boshnjak dhe serb në kampet e përqendrimit kanë reaguar me një komunikatë të ashpër të përbashkët, duke ia tërhequr vërejtjen publikut, mediave dhe ambasadave se vetëm shoqatat e të burgosurve nëpër kampet e përqendrimit janë kompetent për t’u marrë me kampet e përqendrimit. Projekti është në vazhdim e sipër, me përkrahjen e CRD, NED dhe RBF⁶.

Avokuesit publik të KOMRA-s⁷

Avokuesit publik të Nismës për KOMRA në datën **24.01.2014** kanë mbajtur takim në Beograd, i cili i është kushtuar marrëveshjes në lidhje me organizimin e Kuvendit të Koalicionit për KOMRA, që do të duhej të vendoste nëse *Ndryshimet e Statutit të KOMRA-s (Ndryshimet)*, të cilat i bëjnë të dërguarit për KOMRA-n, kurse kryetarët/anëtarët e Presidencës së B dhe H i pranojnë si dokument mbi mundësitë juridike dhe kushtetuese të themelimit të KOMRA-s, pra, nëse *Ndryshimet* janë në përputhje me intencat themelore dhe me thelbin e Propozim Statutit të KOMRA-s, të cilin e propozon Koalicioni [Propozim Statuti]. Duke e pasur parasysh faktin se të dërguarve iu janë të nevojshëm edhe disa muaj në mënyrë që të përfundojnë me kontrollin dhe analizën e dispozitave të Propozim Statutit, avokuesit publik kanë vlerësuar se është e mundshme që Kuvendi i Koalicionit të KOMRA-s të organizohet nga fundi i muajit tetor të vitit 2014.

Të njëjtën ditë, në datën **24.01.2014**, në Beograd, avokuesit publik kanë mbajtur **konferencën për shtyp**, në të cilën kanë folur Zharko Puhovski, Dino Mustafiqi, Adriatik Kelmendi dhe Natasha Kandiç. Ata iu kanë bërë thirrje vendeve post-jugosllave që së bashku të themelojnë KOMRA-n, që ka potencial për të ulur tensionet dhe urrejtjen etnike, t’i kontribuojë ndërtimit të kulturës së bashkë ndjesisë, solidaritetit dhe respektimit të viktimave të luftës në hapësirën e ish Jugosllavisë.

vërtetimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut gjatë luftës në B dhe H.

⁶ Civil Rights Defenders, The National Endowment for Democracy, The Rockefeller Brothers Fund.

⁷ Profesorët Zdravko Grebo, Zharko Puhovski, dhe Zhidas Daskalovski (i cili në muajin tetor të vitit 2013 e ka zëvendësuar profesoreshën Biljana Vankovska pas vendimit të saj për t’u tërhequr, për arsye morale, lidhur me përpjekjen e saj të pasuksesshme për të siguruar pjesëmarrjen aktive të të dërguarit personal të kryetarit Ivanov në punën e Grupit të Ekspertëve Rajonal), gazetarët, Adriatik Kelmendi, Dushko Vuković, Xhenana Karup Drushko, Dinko Gruhonjiq [Igor Mekina, në muajin janar të vitit 2014 ka pushuar së angazhuari në procesin KOMRA], regjisori Dino Mustafiq dhe Natasha Kandiç, koordinatorë e procesit KOMRA

Vlerësimin mbi përparimin e procesit KOMRA e ka dhënë profesori Puhovski, duke thënë se „KOMRA ia ka dalë ta arrij deri te edhe vetëm një hap për t’u bërë organ ndërshtetëror, i cili merret me çështjet e së kaluarës“.

Mbi procesin KOMRA si dhe mbi (mos)pjesëmarrjen e të dërguarit të kryetarit të Maqedonisë në punën e Grupit të Ekspertëve Rajonal, avokuesit publik, Adriatik Kelmendi, Natasha Kandiç dhe Zhidas Daskalovski, si dhe koordinatorja kombëtare e procesit KOMRA, Petranka Kostadinova Miladinova, kanë folur në datën **6.02.2014** në Shkup me zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Maqedonisë Fatmir Besimin. Zëvendëskryeministri i Qeverisë e ka shprehur përkrahjen e fuqishme për formimin e Komisionit Rajonal, i cili do të merret edhe me viktimat e luftës në Maqedoni. Sa ka të bëjë me të dërguarin e kryetarit Ivanov, ai ka shprehur qëndrimin se pjesëmarrja e tij në punën e Grupit të Ekspertëve Rajonal është thelbësore, si për shkak të përforcimit të bashkëpunimit rajonal, po ashtu edhe për shkak të vet viktimave.

Avokuesi publik, profesori Zhidas Daskalovski, në datën **3.06.2014** ka pasur një takim me të dërguarin e kryetarit të Maqedonisë, Luben Arnaudoskin, i cili e ka vërtetuar përkrahjen e parezervë të kryetarit Ivanov për Nismën për themelimin e KOMRA-s dhe e ka theksuar se vendimi mbi themelimin e KOMRA-s është në kompetencë të Qeverisë. Sa ka të bëjë me Grupin e Ekspertëve Rajonal, L. Arnaudoski e ka paraqitur qëndrimin se ai me kujdes po e përcjell punën e tij dhe se e përkrah atë.

Në periudhën e vëzhguar, avokuesit publik kanë komunikuar në baza ditore, me e-mail dhe me skype, mbi të gjitha çështjet relevante të procesit KOMRA.

Grupi i Ekspertëve Rajonal për KOMRA

Grupin i Ekspertëve Rajonal e përbëjnë të dërguarit personal për KOMRA të kryetarëve/anëtarëve të Presidencës së B dhe H (të dërguarit)⁸: profesoresha Zlata Gjurgjeviq-Petkoviç, e dërguara e kryetarit të Kroacisë, profesoresha Sonja Shundiç-Tomoviç, e dërguara e kryetarit të Malit të Zi, gjyqtari Sinisha Vazhiç, i dërguar i kryetarit të Serbisë, zëvendëskryetari i Sarajevës Aljosh Çampara, i dërguari i anëtarit të Presidencës së B dhe H, Bakir Izetbegoviç, oficeri për ndërlidhje me GJPNJ Goran Mihaljeviç, i dërguar i anëtarit të Presidencës së B dhe H Zheļjko Komshiqi, dhe këshilltari ligjor Selim Selimi, i dërguar i kryetares së Kosovës Atifete Jahjaga. Kryetari i Maqedonisë Gjorgje Ivanov e ka emëruar të dërguarin e tij personal, por ai nuk ka marrë pjesë në punën e grupit të ekspertëve.⁹ Kryetari i Sllovenisë, Borut Pahor dhe anëtari i tretë i Presidencës së B dhe H, Nebojša Radmanoviç, nuk i kanë emëruar të dërguarit e tyre për KOMRA¹⁰.

Në punën e grupit të ekspertëve rajonal, në emër të Koalicionit për KOMRA dhe të avokuesve publik, kanë marrë pjesë Midhat Izmirlija, anëtar i Grupit Punues të Koalicionit për KOMRA

⁸ Kryetarët/anëtarët e Presidencës së B dhe H i kanë emëruar të dërguarit e tyre personal në periudhën janar – korrik të vitit 2013.

⁹ Kryetari Ivanov e ka emëruar Luben Arnaudoskin, zëvendësin e sekretarit të përgjithshëm për çështje ligjore dhe organizative në kabinetin e tij, si të dërguar personal për KOMRA.

¹⁰ Profesori Zharko Puhovski, në emër të Koalicionit për KOMRA dhe të avokuesve publik, personalisht i është drejtuar kryetarit të Sllovenisë dhe në datën 24.04.2014 ka marrë përgjigjen nga këshilltari i tij për çështje të jashtme, me të cilën e informon se çështja e KOMRA-s është në kompetenca të Qeverisë së Sllovenisë. Ai i ka propozuar Koalicionit për KOMRA që t’i drejtohet Ministrisë për Punë të Jashtme të Republikës së Sllovenisë. Anëtari i tretë i Presidencës së B dhe H kurrë nuk është përgjigjur në letrat dhe paraqitjen publike të drejtuar atij nga ana e Koalicionit për KOMRA për emërimin e të dërguarit për KOMRA.

për Statut, dhe Natasha Kandiçi, koordinatorë e procesit KOMRA. Detyra e tyre ka qenë e natyrës teknike, që të ofrojë interpretim të neneve të Propozim Statutit të KOMRA-s, të cilin e ka propozuar Koalicioni [Propozimi i Statutit], dhe që të përkujdesen që të gjitha propozimet e të dërguarve me kohë dhe në mënyrë besnike të jenë futur në *Ndryshimet*. Në punë, përkohësisht, në cilësinë e vëzhguesve, kanë marrë pjesë edhe avokuesit e tjerë publik.

Detyrë e të dërguarve për KOMRA-n, të cilën e ka formuluar kryetari i Kroacisë Ivo Josipović, është analiza e Propozim Statutit të KOMRA-s nga këndi i mundësive kushtetuese, juridike dhe politike për themelimin e KOMRA-s, në secilin vend individualisht. Të dërguarit i kanë mbajtur gjithsejtë katër takime, dy takime në vitin 2013, në datën 8 shtator dhe 24 tetor, të dyja në Zagreb, dhe, deri në fund të vitit 2014, dy takime – në datën 8 mars në Zagreb dhe në datën 4 maj në Beograd. Në takimin tjetër, të dërguarit kanë sjellë vendimin që të konsultohen me kryetarët/anëtarët e Presidencës së B dhe H mbi „periudhën dhe fushën e hulumtimit“ të Komisionit para se t’ua dërgojnë versionin final të *Ndryshimeve* për kontroll dhe vendosje.

Të dërguarit kanë filluar me konsultimet në muajin maj dhe deri në fund të vitit 2014 ato ende kanë qenë në zhvillim e sipër. Avokuesit publik kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në konsultimet e përmendura.

!Zëri i Nismës për KOMRA

Koalicioni për KOMRA, në periudhën janar – qershor të vitit 2014 e ka botuar një numër të revistës **!Zëri i Nismës për KOMRA**, i cili i është kushtuar pajtimit, të vështruar nga këndi i veteranëve, për çka flet edhe dr. Lea David, ligjëruese në universitetin *Ben Gurion* në Tel Aviv. Veterani i Armatës së B dhe H, Narcis Mishanoviçi në moshën e tij 11 vjeçare është inkuadruar në ushtri, pas vrasjes së vëllait dhe të babait të tij. Për te pajtimi është i mundshëm nëse krijohen garanci që askush të mos përjetoj atë që ka përjetuar ai – të jetojë pa baba dhe të marrë pushkën në dorë. Spasoje Kulaga, veteran i Ushtrisë së Republika Srpska, B dhe H, ka dalë nga lufta si invalid i qind për qindtë. Ai beson se puna e përbashkët e njerëzve, të cilët kanë luftuar në anë të ndryshme, i kontribuon largimit të urrëjtjes, që është kusht për pajtimin. Zvonko Luciq, veteran i ushtrisë kroate, i cili ka qenë më shumë se një vit në luftimet e zhvilluara në rrethinën e Mostarit, bart në vete dëshpërimin lidhur me atë se pjesë e kujt ka qenë, se çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur. Gani Balaj, pjesëtar i ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës konsideron se Serbia së pari duhet të kërkojë falje për krimet të cilat i ka kryer, dhe vetëm pas kësaj vjen bashkëpunimi me veteranët e Serbisë. Dalibor Trajkoviçi në Kosovë ka shkuar si ushtar i rregullt, kurse është kthyer me trauma të mëdha. Për te, respektimi i të tjerëve si njerëz është kusht për shërimin dhe pajtimin. Lea David me vite i ka hulumtuar qëndrimet e Kroacisë dhe të Serbisë ndaj veteranëve. Rezultatet e hulumtimit të saj provojnë se veteranët në Kroaci përbëjnë, jo vetëm bashkësinë më të fortë dhe më me ndikim të kujtesës, por edhe bashkësinë me ndikim të shprehur politik. Ajo ia përshkruan këtë faktit se Kroacia nga lufta ka dalë ngadhënjimtare, dhe, së këndejmi, elitat pushtetore të pasluftës i kanë promovuar veteranët si heronj të luftës për interesat e tyre vetjake. Në Serbi, vlerëson Lea David, veteranët janë marginalizuar dhe stigmatizuar. Narrativët e tyre nuk janë të pranishëm në skenën publike, që e forcon bashkësinë e përkujtimit të lejuar vetëm në sferën private, si edhe pas Luftës së Dytë Botërore.